REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:054186

Datë: 26.06.2020

Numri i dokumentit: 00992054

P.nr.284/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN/ Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Veli Kryeziu, me sekretaren juridike Fikrije Rexhepi, ne çështjen penale ndaj të pandehurve L.Q nga Gjilani me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av.Flamur Ahmeti, i pandehuri V.M nga Gjilani me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare av.Begzad Hajrullahu, sipas dispozitivit I në bashkëveprim si bashkëegzekutor kanë kryer veprën penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185, paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe i pandehuri F.C nga Gjilani me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av.Fadil Sinanaj,sipas dispozitivit II ka kryer veprën penale Lëndimi lehtë trupor nga neni 185, paragrafi 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.591/2020 të datës 29.05.2020, të cilën e përfaqëson prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar më datë 17.06.2020, publikisht shpalli, ndërsa më 26.06.2020 përpiloi këtë:

A K T GJ Y K I M

I

I pandehuri **L.Q** nga i ati N..., e ëma Sh..., e lindur S..., i lindur më ..., në Gjilan, ku edhe jeton në rr.''....'', p.n, me numër personal identifikues: ....., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i dy fëmijve, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, më parë i pa dënuar.

II

I pandehuri **V.M** nga i ati M..., e ëma G...., e lindur E..., i lindur më ....., në Gjilan ku edhe jeton në rr.''....'', nr. ..., me numër personal identifikues: ..... ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i punësuar si kamerman, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, më parë i pa dënuar.

III

I pandehuri **F.C** nga i ati R...., e ëma F...., e lindur Z...., i lindur më ...., në Gjilan, me vendbanim në fshatin ...., me numër personal identifikues: ....., ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, më parë i pa dënuar.

2020:059589

JANË FAJTORË

S E P S E

I

Të pandehurit L.Q dhe V.M:

Më datë 17.05.2020 rrreh orës 23:00h në Gjilan në lagjen ‘’Dardania’’ përballë ‘’SHPK Durrësi’’, të pandehurit L.Q dhe V.M në bashkëveprim, pas një mosmarrëveshje me të dëtmuarin F.C- tani i pandehur, me dashje dhe me përdorimin e dhunës kanë shkaktuar lëndime trupore të njëjtit, në atë mënyrë që deri sa të tre të pandehurit ishin duke shëtitur me veturën BMW GT me ngjyrë të zezë, kur arrin përballë ‘’SHPK Durrësi’’ për një moment i dëmtuarit F... e godet me thikë të pandehurit L...., ku pastaj të pandehurit L... dhe V... e nxjerrin nga vetura të dëmtuarin duke e goditur me grusht në pjesë të fytyrës, ku si pasojë e lëndimeve trupore, i dëmtuari F...., detyrohet të kërkoj ndihmë mjekësore në Spitalin Regjional të Gjilanit- Emergjencë sipas raportit mjekësor me nr. të protokollit 10788 të datës 17.05.2020.

-me çka në bashkëveprim si bashkëekzekutor kanë kryer veprën penale **Lëndim i lehtë trupor nga neni 185, paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së,**

II

I pandehuri F.C:

Më datë 17.05.2020, rreth orës 23:00h në Gjilan në lagjen ‘’Dardania’’, përballë ‘’SHPK Durrësi’’, i pandehuri F.C, pas një mosmarëëveshje, me të pandehurit e parë L.Q dhe V.M, të dëmtuarit L.Q i shkakton lëndime trupore, ashtu që deri sa të pandehurit ishin duke shëtitur me veturën BMW GT me ngjyrë të zezë, kur arrin përballë ‘’SHPK Durrësi’, i pandehuri F... e godet me thikë, si mjet i rrezikshëm që mund të shkskej lëndim i rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit, të dëmtuarit- tani të pandehurit L..., në krahun e djathtë, i cili si pasojë e lëndimeve, detyrohet të kërkoj ndihmë mjeksore në Spitalin Regjional të Gjilanit- Emergjencë sipas raportit mjekësor me nr. të protokollit 10790 të datës 17.05.2020.

-me çka i njëjti ka kryer veprën penale **Lëndim i lehtë trupor nga neni 185, paragrafi 2 i KPRK-së.**

-Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore si dhe neneve, 4,7,17,38,39,40,43,69,70,71,72,79 si dhe nenit 365 të Kodit Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, të pandehurit:

I GJ Y K O N

I.Të pandehurve **L.Q dhe V.M** i shqiptohet **me dënim me gjobë** në shumë prej **nëntëqind (900) euro**, për secilin veç e veç, dënimi i shqiptuar do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, nga dita pasuese e plotëfuqishëmërisë së këtij aktgjykimi, mirëpo nëse eventualisht të pandehurit nuk dëshirojnë apo nuk mund ta paguajnë dënimin me gjobë në kuptim të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-s i njëjti

I ZËVENDËSOHET me dënim me burgim duke ju llogaritur çdo njëzet 20 euro të barabarta me 1 (një) ditë burgim përkatësisht në kohëzgjatje prej (45) ditë ose në mënyrë përpjesëtimore me pjesën e dënimit të gjobës së pa paguar, të cilin dënim duhet ta filloj ta mbaj në afat prej 15 ditëve nga dita pasuese e pranimit të ftesës nga gjykata.

2020:059589

II. Të pandehurit **F.C** i shqiptohet dënim me burg në kohëzgjatje **prej njëqindenjëzet (120) ditë,** dënimi i shqiptuar do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, nga dita pasuese e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi,
Në bazë të nenit 47 të KPRK-së me pëlqimin e të pandehurit dhe në konsultim me mbrojtësin e tij, kohëzgjatja e dënimit me burgim në kohëzgjatje prej njëqindenjëzet (120) ditëve:
I ZËVENDËSOHET në dënim me gjobë në shumë **prej njëmijëenjëqind (1100) euro,** mirëpo nëse eventualisht i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë në kuptim të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-s i njëjti,

I ZËVENDËSOHET me dënim me burgim duke ju llogaritur çdo njëzet 20 euro të barabarta me 1 (një) ditë burgim përkatësisht në kohëzgjatje prej (55) ditë ose në mënyrë përpjesëtimore me pjesën e dënimit të gjobës së pa paguar, të cilin dënim duhet ta filloj ta mbaj në afat prej 15 ditëve nga dita pasuese e pranimit të ftesës nga gjykata.

Në bazë të nenit 79 të KPRK-së të pandehurve L.Q, V.M dhe F.C t'i llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data **17.05.2020 deri më datë 17.06.2020.**

Të pandehurit L.Q, V.M dhe F.C, **se cili veç e veç obligohen të paguajnë shpenzimet e procedurës penale në shumën prej nga 20.00 € (njëzetë euro),** si dhe taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në shumën prej **30.00 € (tridhjetë euro),** në bazë të nenit 39 paragrafi 3, nën paragrafi 1.3 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, secili prej të pandehurëve, në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A R S Y E T I M

1.Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjilan, me datë 29.05.2020 ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.591/2020, kundër të pandehurve L.Q, V.M në bashkëveprim si bashkëegzekutor sipas paragrafit I kanë kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185, paragrafi 1 lidhur me nenin 31 dhe F.C sipas dispozitivit II ka kryer vepren penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185, paragrafi 2, në të cilin ishin prezent Prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu, të pandehurit L.Q me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av.Flamur Ahmeti, i pandehuri V.M me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare av.Begzad Hajrullahu dhe F.C me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av.Fadil Sinanaj. Në të cilën seancë të pandehurit pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, deklarohen se e kanë kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohen, dhe se e pranojnë fajësinë për kryerjen e veprës penale.

2. *Vlerësimi i pranimit të fajësisë*

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurores së shtetit, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurve L.Q, V.M dhe F.C për kryerjen e veprave penale për të cilën akuzohen, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se të pandehurit e kanë kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht dhe në konsultim me mbrojtësit e tyre, se të pandehurit nuk kanë qenë të detyruar ose të shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojnë fajësinë, se pranimi i

2020:059589

fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3. *Gjendja faktike e vërtetuar*

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi këtë gjendje faktike: se të pandehurit L.Q, V.M dhe F.C kanë kryer veprat penale, në kohën vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratave së të pandehurve, i ka shpallur fajtor të pandehurit L.Q, V.M dhe F.C për kryerjen e vepravepenale, ngase veprimet e të njëjtëve i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtën janë edhe penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se të njëjtit e kanë pranuar edhe vet.

Në bazë të nenit 185, paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të KPRK-së, Lëndimi i lehtë trupor konsiderohet:

1. Kushdo që personit tjetër i shkakton lëndim të lehtë trupor, i cili rezulton në:

1.1. dëmtimin e përkohshëm ose dobësimin e një organi apo pjese të trupit të personit tjetër;

1.2. zvogëlimin e përkohshëm të aftësisë së personit tjetër për të punuar;

1.3. shëmtimin e përkohshëm të personit tjetër; ose

1.4. dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet me armë, mjet të rrezikshëm apo me ndonjë send tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Në bazë të nenit 31 i KPK-së, Bashkëkryerja, konsiderohet:

Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale.

Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit, ka vlerësuar se të pandehurve L.Q, V.M dhe F.C t'i shqiptohet dënimi me gjobë, ngase ka vlerësuar se duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat e shënuara më poshtë, të cilat duke i ndërlidhur njëra me tjetrën, janë vlerësuar rrethana posaçërisht lehtësuese, ky dënim do të jetë një dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale. Me rastin e matjes së dënimit të të pandehurve, gjykata ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, të parashikuara në nenin 69 dhe 72 të KPRK-s, Kështu, si rrethanë posaçërisht lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka zbutur dënimin ndaj të pandehurve ka shqiptuar dënim nën minimumin duke marrë parasysh që të njëjtin e kanë pranuar kryerjen e veprave penale me datë 17.06.2020. Gjithashtu, si rrethana posaçërisht lehtësuese, gjykata ka marrë dhe faktin se të pandehurit kanë bashkëpunuar me prokurorinë e shtetit, se pranimin e fajësisë e kanë bërë në të gjitha fazat e procedurës penale, se të pandehurit janë penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre penale dhe se të njëjtit i kanë premtuar gjykatës se nuk do të kryejnë vepra tjera penale, kanë treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit fillestar. Këto janë rrethana, që tregojnë se edhe me një dënim më të

2020:059589

butë mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe të pandehurit me të drejtë mund të pritet që në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra tjera penale. Ndërsa, rrethanë rënduese është rrezikshmëria e veprës penale dhe lëndimet që të pandehurit i'u kanë shkaktuar njëri tjetrit.

6. <u>Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurve dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar</u>

Gjykata, ka konstatuar se me dënim me kusht mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. *<u>Vendimi për shpenzimet e procedurës penale</u>*

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e të pandehurve, gjykata, duke u bazuar nenin 453 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurit ti obligoj të paguajnë shpenzimet e procedurës penale në shumën prej nga 20.00 € (njëzetë euro), si dhe taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në shumën prej 30.00 € (tridhjetë euro), në bazë të nenit 39 paragrafi 3, nën paragrafi 1.3 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit. secili prej të pandehurëve, në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
Divizioni Penal
P.nr. 284/20, më 26.06.2020

Sekretarja juridike,

Gjyqtari,

Fikrije Rexhepi

Veli Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë / Departamentit të përgjithshëm në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit e të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.

2020:059589